



INFORMATË THEMELORE:

Lajmëruesi i Dezinformatave – Monitorimi i Mediave Ruse është raport mujor i lajmeve që përmbajnë dezinformata dhe keqinformime që e vejnë në shënjestër Kosovën, dhe që janë të botuara në mediat ruse në gjuhën angleze dhe serbe

PËRKRAHUR NGA:



Londër, Mbretëria e Bashkuar

VËREJTJE:

Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim janë vetëm të Institutit Kosovar për Hulumtime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

KONTAKTI:

Instituti Kosovar për Hulumtime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)
Rr. Major Mehmet Bushi, H.III/1
10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0)38 542 778
Web-site: www.kipred.org
Email: info@kipred.org

LAJMËRUES I DEZINFORMATAVE PËR KOSOVËN

MEDIAT RUSE

Tetor 2020

HYRJE

Lajmëruesi i Dezinformatave për Kosovën: Monitorimi i Mediave Ruse synon t'u kundërvihet dezinformatave që e kanë në shënjestër Kosovën, përmes monitorimit në bazë mujore të botimeve të përzgjedhura mediale që dalin në Rusi, si në gjuhën angleze, ashtu edhe në atë serbe. Mediat e përzgjedhura në gjuhën angleze janë Russia Today, Sputnik, Meduza, Russia Insider, TASS, The Moscow Times, Newsfront, Unz, The Duran, dhe Pravda Report, ndërsa në gjuhën serbe është Sputnik Serbia. Pos kësaj, Lajmëruesi i Dezinformatave për Kosovën i monitoron lajmet, dokumentet dhe deklaratat që kanë të bëjnë me Kosovën, të botuara nga Kremli dhe nga Ministria Ruse e Punëve të Jashtme.

Gjatë muajit tetor 2020, Russia Insider i ka botuar 2 lajme, TASS-i 1, Newsfronti 7, Unzi 1, Russia Today 4, Sputnik International 4, Meduza 1, ndërkohë që Sputnik Serbia i ka botuar 179 lajme që kanë patur të bëjnë drejtpërdrejt apo tërthorazi me Kosovën. Ndërkaq, The Duran, The Moscow Times dhe Pravda Report nuk kanë botuar asnjë lajm lidhur me Kosovën. Nga ana tjetër, gjatë kësaj periudhe monitoruese, në ueb-sajtet e tyre Kremli e kishte një, dhe Ministria e Jashtme Ruse 2 postime që kishin të bënin me Kosovën.

Për shkak të numrit të madh të artikujve me përmbajtje dezinformuese të lëshuara nga këto media, në këtë botim janë analizuar vetëm artikujt me përmbajtjet dezinformuese më flagrante. Dezinformata e ofruar synon t'ia shkatërrojë themelet shtetësisë së Kosovës duke bërë krahasime të pavend të kësaj shtetësie me gjendjen në Nagorno-Karabakh, duke i paraqitur këto si konflikte të ngrira. Për më tepër, këto media e akuzojnë NATO-n për krime të luftës kundër popullatës serbe, duke ekzagjeruar numrin e viktimave serbe gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s të vitit 1999.

DEKONSTRUKTIMI I DEZINFORMATAVE TË DETEKTUARA

Lajmërim i Dezinformatës 1

Titulli: Vučić compared the situation in Karabakh with Kosovo [Vuçiqi e krahasoi situatën në Karabakh me Kosovën], **Newsfront, 3 tetor 2020.**¹

Në takimin me Kongresin Kombëtar Serb për Hyrjen në BE, Presidenti serb Aleksandar Vuçiq u përpoq të tërhiqte paralele midis Kosovës dhe Nagorno-Karabakhut. Ai deklaroi që “Në këtë konflikt e kemi parë pafuqinë e plotë të të tërë bashkësisë ndërkombëtare, kështu që unë jam kundër konflikteve të ngrira në Ballkan. Ajo që është duke ndodhur në Nagorno Karabakh është një mësim i madh për të gjithë ne, meqë konfliktet e ngrira donë të thonë përplasje në të ardhmen para të cilave bashkësia ndërkombëtare është e pafuqishme. Kjo është pse jam në favor të zgjidhjes së çështjeve sot dhe nesër, dhe jo që ato t’ua lëmë fëmijëve tanë.”

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Politikanët rusë dhe serbë janë përpjekur vazhdimisht të tërheqin paralele midis Kosovës dhe rasteve të tjera, si Krimea,² Republika Serbe,³ ose, si në këtë rast, me Nagorno-Karabakhun. Para së gjithash, dhe mbi të gjithat, Kosova është një rast unik, “sui generis,” që nuk mund të krahasohet, as me Nagorno-Karabakhun, as me ndonjë rast tjetër të diskutueshëm sipas të drejtës ndërkombëtare.

Ka arsye të shumta që Kosovën e përcaktojnë si një rast të paprecedent:⁴

¹ Vučić compared the situation in Karabakh with Kosovo [Vuçiqi e krahasoi situatën në Karabakh me Kosovën], <https://en.news-front.info/2020/10/03/vucic-compared-the-situation-in-karabakh-with-kosovo/>.

² Putin Says Kosovo Precedent Justifies Crimea Secession [Putini thotë se Precedenti i Kosovës e Përligj Secesionin e Krimesë], <https://balkaninsight.com/2014/03/18/crimea-secession-just-like-kosovo-putin/>.

³ Bosnia: Kosovo, Republika Srpska identical situations [Bosnja: Kosova dhe Republika Serbe situata identike], <https://www.aa.com.tr/en/europe/bosnia-kosovo-republika-srpska-identical-situations/1920574>.

⁴ Për më shumë hollësi shih: “KOSOVO: THE UNPRECEDENTED STATE [KOSOVA: SHTET I PAPRECEDENT], KIPRED, korrik 2007, http://www.kipred.org/repository/docs/KOSOVO,_THE_UNPRECEDENTED_STATE_153256.pdf.

- Spastrimi etnik dhe përpjekja për gjenocid që është bërë kundër popullatës civile në Kosovë.
- Shpërbërja e shtetit të përbashkët – Përgjithësisht është e ditur që shpërbërja e Jugosllavisë filloi më shfuqizimin e dhunshëm të autonomisë së Kosovës në vitin 1989.
- Përfaqësimi i barabartë në nivelin federativ në strukturën paraprake – Si njësi përbërëse federale, miratimi i Kosovës ishte i domosdoshëm për të gjitha vendimet ekzekutive, legislative dhe gjyqësore në nivelin federal.
- Degradimi i paligjshëm i statusit të Kosovës.
- Territori i përcaktuar qartë me kufij të qartë.
- Administrimi ndërkombëtar i Kosovës – Kosova është administruar nga KB deri në vitin 2008.

Kështu, të gjitha këto fakte Kosovën e bëjnë një rast të paprecedent, dhe si i tillë, ky nuk mund të krahasohet me asnjë nga rastet e tjera. Lidhur me këtë, duhet të përmendet edhe ajo se opinioni këshillues i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) përfundoi se shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 nuk e ka shkelur rezolutën 1244 të KS KB, dhe as ndonjë normë tjetër legale ndërkombëtare.⁵ Për më tepër, rezoluta 1244 nuk e ka parandaluar apo përjashtuar mundësinë e pavarësisë së Kosovës, ajo vetëm e ka përcaktuar administrimin e përkohshëm të Kosovës, por jo si ndonjë status përfundimtar apo të përhershëm.⁶

⁵ Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Opinioni Këshillues për pajtueshmërinë me të drejtën ndërkombëtare të shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës, 22 korrik 2010:

<https://www.icj-cij.org/public/files/case-related/141/141-20100722-ADV-01-00-EN.pdf>.

⁶ Ibid.

Lajmërim i Dezinformatës 2

Titulli: Trove of Declassified Docs Reveals What Putin Told Clinton About Kursk Sinking, Yugoslavia, Terror [Një mori dokumentesh të deklasifikuara zbulojnë se çfarë Putini i kishte thënë Clintonit për fundosjen e Kurskut, për Jugosllavinë, për Terrorin], **Sputnik International**, 5 tetor 2020.⁷

Artikulli i nënvizon bisedat private midis Presidentit Vladimir Putin dhe Presidentit Bill Clinton. Ndër të tjera, ky artikull flet për situatën në Jugosllavi, duke pohuar në mënyrë të rrejshme se “Midis marsit dhe qershorit të vitit 1999, mbi gjysmë viti para se Putini ta merrte presidencën ruse, për 78 ditë NATO-ja e ka kryer një fushatë bombarduese të shkallës së gjerë kundër Jugosllavisë, e cila i la mbi 5.000 civilë të vdekur.”

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Mediat ruse e kanë ekzagjeruar në mënyrë të vazhdueshme numrin e viktimave të bombardimit të NATO-s të vitit 1999. Në mënyrë të ngjashme me këtë artikull, Sputnik International e ka botuar në vitin 2019 një artikull që u përqendrua në ish-Sekretaren e Shtetit të SHBA-ve, Madeleine Albright, dhe që, mes tjerash, rrejshëm pohonte se bombardimet e NATO-s i lanë mbi 5.000 viktima.⁸ Të dhënat e detajuara të grumbulluara bazuar në 31.600 dokumente, të paraqitura në botimin “Libri i Kujtesës i Kosovës” (2 shkurt 2015), i cili u përgatit nga Qendra për të Drejtën Humanitare me seli në Beograd, konfirmojnë se në sulmet e NATO-s janë vrarë gjithsej 754 njerëz: 454 civilë dhe 300 anëtarë të forcave të armatosura. 207 civilë ishin të etnisë serbe dhe malazeze, 219 ishin shqiptarë, 14 civilë ishin romë, dhe 14 ishin të kombësive të tjera. E qartë,

⁷ Trove of Declassified Docs Reveals What Putin Told Clinton About Kursk Sinking, Yugoslavia, Terror [Një mori dokumentesh të deklasifikuara zbulojnë se çfarë Putini i kishte thënë Clintonit për fundosjen e Kurskut, për Jugosllavinë, për terrorin], <https://sputniknews.com/world/202010051080674054-trove-of-declassified-docs-reveal-what-putin-told-clinton-about-kursk-sinking-yugoslavia-terrorism/>.

⁸ Serbs Mercilessly Mock Madeleine 'Worth It' Albright's New Kosovo Statute [Serbët e tallin në mënyrë të pamëshirshme statutin e ri të Kosovës të Madeleine ‘të vlefshme’ Albright], <https://sputniknews.com/europe/201906131075842989-serbs-mercilessly-mock-madeleine-worth-it-albrights-new-kosovo-statute/>.

të dhënat e dokumentuara tregojnë pra se numri i vdekjeve gjatë Fushatës Ajrore të NATO-s ishte shumë më i ulët se numri 5,000 i paraqitur në këtë artikull.

Lajmërim i Dezinformatës 3

Titulli: Serbia-Kosovo ‘normalization of relations’ plan: Will Belgrade give in to Western demands & shift toward ‘mutual recognition’? [Plani Serbi-Kosovë “për normalizimin e marrëdhënieve”: A do të dorëzohet Beogradi para kërkesave Perëndimore dhe të zhvendoset kah ‘njohja e ndërsjellë’?] **RT, 20 tetor 2020.**⁹

Artikulli e shqyrton zgjidhjen përfundimtare të çështjes së Kosovës, duke theksuar atë se për Perëndimin e vetmja zgjidhje përfundimtare për çështjen e Kosovës do të jetë njohja e Kosovës nga Serbia si një shtet i pavarur. Ndër të tjera, artikulli pretendon në mënyrë të rrejshme se “Kosova, e cila ka qenë nën administrimin e KB-ve që nga bombardimi i vitit 1999 i Jugosllavisë nga NATO-ja, njihet si një shtet i pavarur nga pjesa më e madhe e Perëndimit, edhe përkundrejt asaj që Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurisë së KB Kosovën e rikonfirmon si pjesë të Serbisë.”

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Artikulli pretendon në mënyrë të rrejshme se Kosova ka qenë nën administrimin ndërkombëtar që nga bombardimi i NATO-s. Në të vërtetë, Kosova ka qenë nën administrimin ndërkombëtar përmes rezolutës 1244 të KS KB,¹⁰ dhe Rusia ka votuar në favor të kësaj rezolute.¹¹

⁹ Serbia-Kosovo ‘normalization of relations’ plan: Will Belgrade give in to Western demands & shift toward ‘mutual recognition’? [Plani Serbi-Kosovë “për normalizimin e marrëdhënieve”: A do të dorëzohet Beogradi para kërkesave Perëndimore dhe të zhvendoset kah ‘njohja e ndërsjellë’?] <https://www.rt.com/op-ed/503993-serbia-kosovo-us-recognition/>.

¹⁰ Rezoluta 1244 (1999) e Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/old_dnn/Res1244ENG.pdf.

¹¹ United Nations, Digital Library [Kombet e Bashkuara, Biblioteka Dixhitale], <https://digitallibrary.un.org/record/285560?ln=en>.

Për më tepër, artikulli pohon rrejshëm që Kosova është njohur si shtet i pavarur nga pjesa më e madhe e Perëndimit, edhe përkundrajt asaj që rezoluta 1244 e KS KB e rikonfirmon Kosovën si pjesë të Serbisë. Në të vërtetë, rezoluta 1244 Kosovën e njeh si pjesë të Republikës Federale të Jugosllavisë, e cila tash nuk ekziston më. Mbetja e kësaj Federtate, domethënë, e Republikës Federale të Jugosllavisë, e cila më vonë u shndërrua në Unionin e Serbisë dhe Malit të Zi, po ashtu u nda në vitin 2006, kur 55,53% të qytetarëve të Malit të Zi votuan për pavarësi, gjë kjo që në fund e dobësoi dhe e errësoi çfarëdo qoftë lidhjeje legale midis Kosovës dhe Serbisë. Me 17 shkurt, Kosova e shpalli pavarësinë bazuar në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës,¹² të paraqitur nga i Dërguari i KB-ve, ish-Presidenti Finlandez, Ahtisaari, i cili u kundërshtua nga Rusia.

Lidhur me këtë, duhet të vërehet se më 22 korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e dha opinionin këshillues që e konfirmonte se shpallja e pavarësisë së Kosovës e 17 shkurtit 2008 nuk e ka shkelur, as rezolutën 1244 të KS KB, dhe as ndonjë normë tjetër legale ndërkombëtare.¹³

¹² Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement [Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës], https://web.archive.org/web/20091015082628/http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf.

¹³ Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Opinioni Këshillues për pajtueshmërinë me të drejtën ndërkombëtare të shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës, 22 korrik 2010: <https://www.icj-cij.org/files/case-related/141/141-20100722-ADV-01-00-EN.pdf>.